

Tirane më, 26.05.2020

Lënda: Kërkesë Qëndresës Qytetare

Drejtuar: Qëndresës Qytetare

TIRANË

Të nderuar antarë të Qëndresës Qytetare!

Pasojat e lëna nga pandemia COVID-19 janë të mëdha, ku përpos dëmit shëndetësor renditet edhe ai ekonomik, e nga kjo kategori të prekur ndjeshëm janë edhe studentët, të cilët përveç se në gjendje të rënduar psikologjike, po përballen me shumë vështirësi në ndjekjen e procesit mësimor online.

Ne studentët e Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, përmes kësaj shkrese të hapur kërkojmë të ndajmë me Ju shqetësimin tonë kryesor lidhur me aspektin financiar.

Është e kuptueshme si çdokush tjetër në shoqërinë tonë, edhe Studentët janë të prekur ndjeshëm financiarisht gjatë këtij simestri të vitit akademik, ndaj në këto kushte duhet të merrni në konsideratë si më poshtë:

a) Familjet Shqiptare po përballen me një situatë të vështirë ekonomiko-fianciare, për shkak të masave të ndërmarra nga Qeveria për përballimin e pandemisë COVID-19, ndikim ky direkt në financat e Studentëve, si pjesë e këtyre familjeve të prekura.

b) Studentët për simestrin e dytë të vitit akademik po marrin minimumin e shërbimeve nga Universiteti (proçesi i zhvillimit të mësimin vetëm online dhe jo i plotë), situatë kjo që ka sjellë minimizimin e kostos të operimit të Universitetit.

Sa më sipër, vlersojmë të arsyeshme të kërkojme nga ana Juaj:

Vënien në dijeni të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë lidhur me përgjysmimin e tarifave për të gjithë studentët.

Masat lehtësuese financiare të kërkuara sa më lartë nuk mbulojnë efektin e krijuar nga kjo gjendje, por zbusin efektet e sajë për Studentët dhe janë në raport të drejtë me shërbimet e marra prej tyre.

Duke e konsideruar të rëndësishme këtë kërkesë, presim nga ana Juaj një përgjigje!

Sinqerisht

Studentet e Fakultetit të Ekonomisë !